



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 26 prill 2012
Nr. ref.: RK227/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI05/11

Parashtruesi

Federata Sindikale e Shëndetësisë së Kosovës

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Deklaratës së Përbashkët, Nr. 122/08,
të 14 tetorit 2008**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruese e kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është Federata Sindikale e Shëndetësisë së Kosovës (në tekstin e mëtejme: FSSHK), e përfaqësuar nga z. Armend Shkoza, avokat nga Mitrovica, që vepron sipas autorizimit të 13 janarit 2011, të nënshkruar nga Kryetari i FSSHK-së, z. Blerim Sylja.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e konteston Deklaratën e Përbashkët Nr. 122/08 të 14 tetorit 2008, të lidhur ndërmjet parashtrueses, Këshillit Qendror Grevist dhe Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ministria).

Objekti i çështjes

3. Parashtruesja pohon për shkelje të nenit 93 [Kompetencat e Qeverisë], paragrafëve 6 dhe 7, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenit 23.2 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, dhe neneve 62 [Drejtorët Komunalë], paragrafi 3, dhe 24 [Parimet themelore të financave komunale], paragrafi 4, të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Nr. 03-L-040).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesja më 17 janar 2011 e parashtrroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 14 shkurt 2011, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KIO5/11, e caktoi gjyqtaren Iliriana Islami Gjyqtare raportuese. Po të njëjtën datë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. KSH. KIO5/11, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Snezhana Botusharova (kryesuese), Almiro Rodrigues dhe Kadri Kryeziu.
7. Më 4 maj 2011, Gjykata Kushtetuese i njoftoi Qeverinë dhe të 14 komunat (shih Shtojcën A) për parashtrimin e kërkesës.
8. Më 16 qershor 2011, Gjykata Kushtetuese kërkoi informacion shtesë nga parashtruesja, Qeveria dhe komunat.
9. Më 24 qershor 2011, komuna e Fushë Kosovës u përgjigj duke thënë se e kishin zbatuar në tërësi Deklaratën e Përbashkët.
10. Më 27 qershor 2011, komuna e Lipjanit u përgjigj duke thënë se do ta kompensojnë shumën e mbetur, sa më shpejt që të jetë e mundur, pas rishikimit të buxhetit për vitin 2011.
11. Më 28 qershor 2011, parashtruesja u përgjigj duke thënë se ka kërkuar nga komunat që ta zbatojnë Deklaratën e Përbashkët dhe gjithashtu e ka njoftuar Qeverinë Qendrore se Deklarata e Përbashkët nuk është zbatuar në tërësi.
12. Më 1 korrik 2011, komuna e Vushtrrisë u përgjigj duke thënë se i kanë përmbushur të gjitha detyrimet lidhur me Deklaratën e Përbashkët.
13. Më 6 korrik 2011, komuna e Klinës u përgjigj duke thënë se do t'ua paguajë shumën e mbetur punëtorëve shëndetësorë sa më shpejt që të jetë e mundur.

14. Më 18 korrik 2011, komuna e Klinës ia dërgoi Gjykatës Kushtetuese vendimin për ndarjen e mjeteve financiare për t'ua kompensuar shumën e mbetur punëtorëve shëndetësorë.
15. Deri më tani, 11 komuna nuk i janë përgjigjur kërkesës për informacione.
16. Më 28 korrik 2011, Gjykata Kushtetuese kërkoi informacione shtesë nga Qeveria, duke përfshirë Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Administratës Publike, dhe Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave, të cilat u përgjigjën më 9, 10, 11 dhe 15 gusht 2011.
17. Më 12 tetor 2011, Gjykata kërkoi nga parashtruesja që ta dorëzonte autorizimin e anëtarëve të FSSHK-së për Kryetarin e FSSHK-së, z. Blerim Sylja, si dhe listat me emrat e punëtorëve të kujdesit shëndetësorë për secilën komunë veç e veç, të cilët pohojnë se komunat përkatëse nuk ua kanë paguar kompensimin prej 44 eurove, të cilin ato e bënë më 30 nëntor 2011.
18. Më 21 mars 2012, Gjykata kërkoi nga parashtruesi të dorëzonte informacione nëse kanë filluar ndonjë procedurë në ndonjërin nga gjykatat e rregullta në Kosovë lidhur me çështjen e ngritur në Gjykatën Kushtetuese.
19. Më 22 mars 2012, parashtruesja iu përgjigj Gjykatës se nuk kanë ngritur asnjë procedurë tjetër në gjykatat e rregullta sepse vetëm Gjykata Kushtetuese është kompetente për të vendosur për aktin e Deklaratës së Përbashkët të nënshkruar nga përfaqësuesit e FSSHK-së dhe Qeveria e Republikës së Kosovës. Më tej, gjoja, Ligji për konfliktet administrative nuk u lejon të fillojnë procedurë për konflikt administrativ.
20. Kolegji shqyrtues më 19 prill 2012 e shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

21. Parashtruesja është e regjistruar si person juridik në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në përputhje me Vendimin 200/06, të lëshuar më 11 prill 2006, dhe Vendimin 531 të 1 shkurtit 2010.
22. Më 13 tetor 2008, parashtruesja, e cila i përfaqëson interesat e anëtarëve të vet, të cilët janë punëtorë shëndetësorë, organizoi një grevë në nivel të vendit me qëllim të përmbushjes së kërkesës legjitime të punëtorëve shëndetësorë.
23. Negociatat pasuese ndërmjet parashtrueses, Këshillit Qendror Grevist dhe Ministrisë së Shëndetësisë rezultuan në një deklaratë të përbashkët ndërmjet tyre dhe Ministrisë së Shëndetësisë.
24. Deklarata e Përbashkët u nënshkrua më 14 tetor 2008, e cila siguronte që 13.247 punëtorë shëndetësorë do të merrnin kompensim në vlerë prej 44 eurove. Kompensimi do të paguhej gjatë dy vjetëve të ardhshme nga komunat, të cilave Qeveria do t'ua ndante mjetet e nevojshme financiare.
25. Pas nënshkrimit të Deklaratës së Përbashkët filluan të paraqiten probleme lidhur me zbatimin e saj, pasi palët e interpretonin atë në mënyra të ndryshme.
26. Si rrjedhojë, kompensimi prej 44 eurove nuk u pagua nga komunat, të cilat sipas Ligjit për vetëqeverisjen lokale bartin kompetencën për menaxhimin e sektorit të kujdesit primar shëndetësor.

27. Më 24 shkurt 2009, punëtorët shëndetësorë organizuan grevë me qëllim të zbatimit të Deklaratës së Përbashkët të 14 tetorit 2008.
28. Për ta sanuar këtë problem, më 3 mars 2009 Kryeministri mbajti një takim publik me krerët komunalë, në të cilin ishin të pranishëm edhe anëtarët e Këshillit Kombëtar të parashtrueses, si dhe Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut si palë e tretë dhe garantues për vazhdimin e zbatimit të Deklaratës së Përbashkët. Në këtë takim, Kryeministri ka kërkuar nga krerët komunalë vazhdimin e zbatimit të Deklaratës së Përbashkët.
29. Më 26 gusht 2009, për t'iu shmangur keqkuptimeve të mundshme, Ministria e Ekonomisë dhe e Financave kërkoj nga kryetarët e të gjitha komunave vazhdimin e pagesës së kompensimit në shumë prej 44 eurove.
30. Që nga miratimi i Deklaratës së Përbashkët, parashtruesja ka qenë duke e vëzhguar zbatimin e saj dhe i ka identifikuar pengesat në zbatimin e saj nga komunat përkatëse, të cilat janë përgjegjëse për sektorin e kujdesit primar shëndetësor.
31. Më 23 gusht 2010, Ministria e Ekonomisë dhe e Financave ua dërgoi qarkoren buxhetore të gjitha komunave, duke konfirmuar se ua kishte alokuar mjetet e nevojshme për t'ua paguar punëtorëve të kujdesit primar shëndetësor kompensimin prej 44 eurove.

Pretendimet e parashtrueses

32. Parashtruesja pretendon se 14 komuna (shih Shtojcën A) gjatë vitit 2009 dhe 2010 nuk i kanë kryer obligimet e tyre për pagesën e kompensimit në lartësi prej 44 eurove.
33. Parashtruesja pohon që komunat në fjalë, me veprimet e tyre, e kanë shkelur kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e rendit juridik të Republikës së Kosovës, si dhe marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.
34. Në veçanti, neni 93, paragrafët 1, 6 dhe 7, i Kushtetutës, nenet 62 (3) and 24 (4) të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, dhe neni 23 (2) i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut janë shkelur për shkak të moszbatimit të Deklaratës së Përbashkët të Qeverisë lidhur me kompensimin në lartësi prej 44 eurove.
35. Parashtruesja pohon që me zbatimin jo të drejtë të Deklaratës së Përbashkët është bërë diskriminimi i punëtorëve shëndetësorë të kujdesit primar, afërsisht rreth 3.545 (nga 5.892 punëtorë), për shkak se kolegëve të tyre nga kujdesi sekondar dhe terciar, si dhe të disa njësisive të sektorit të kujdesit primar shëndetësor, u kompensohej shtesa prej 44 eurove.
36. Përveç kësaj, parashtruesja pohon që komunat në fjalë nuk e zbatojnë Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2010 (Ligji Nr. 03/L-177, të 14 janarit 2010), në të cilin janë paraparë mjetet për pagesën e kompensimit prej 44 eurove edhe për sektorin e kujdesit primar shëndetësor nga organet komunale.
37. Së fundi, parashtruesja kërkon nga Gjykata:
 - Ta vërtetojë detyrimin e komunave përkatëse për pagesën e kompensimit prej 44 eurove për të gjithë punëtorët e kujdesit primar shëndetësor dhe ta evidentojë cenimin e kushtetutshmërisë në lidhje me Kapitullin VI, nenin 93 (1) dhe (6) mbi

kompetencat e Qeverisë, si dhe cenimin e ligjshmërisë lidhur me zbatimin e Ligjit Nr. 03/L-177 për ndryshimin dhe plotësimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës;

- T'i obligojë këto komuna që për vitet 2009 dhe 2010 t'i shlyejnë të gjitha detyrimet ndaj punëtorëve shëndetësorë, në afat kohor jo më vonë se tre mujori i parë i vitit 2011;
- Ta vërtetojë vazhdimësinë e Deklaratës së Përbashkët të 14 tetorit 2008;
- T'i obligojë organet kompetente komunale që të gjithë veprimtarinë e tyre financiare ta kryejnë në përputhje me Ligjin mbi ndryshimin dhe plotësimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitin 2010 (Ligji Nr. 03/L-177);
- Të sigurojë që kompensimin prej 44 eurove, që nuk mund të jepet në emër të shujtës ditore, të e gëzojnë të gjithë punëtorët pa marrë parasysh nëse e shfrytëzojnë a jo ndonjërin nga pushimet e parapara me legjislacionin në fuqi.
- T'i identifikojë mjetet e dedikuara për performancë dhe ta bëjë diferencimin e pagesës prej 44 euro nga ato të performancës;
- T'i lirojë të gjithë parashtruesit nga të gjitha shpenzimet procedurale që paraqiten në këto procedura.

Përgjigja nga Qeveria dhe Ministrinë përkatëse

38. Më 15 gusht 2011, Qeveria dhe Ministrinë përkatëse u përgjigjën:

“Niveli primar i shëndetësisë është në përgjegjësinë e plotë të komunave; prandaj komunat janë të obliguara që për këtë nivel të sigurojnë mjete nga të hyrat vetanake dhe të paguajnë shumën prej 44 euro, meqë me decentralizimin e shpenzimeve nga Ministria e Financave, menaxhimi i drejt dhe në kohë i buxhetit komunal është përgjegjësi e organizatave buxhetore në nivel lokal. Poashtu, Ministria e Administratës Publike, është e gatshme për ekzekutimin e këtyre mjeteve posa të sigurohen mjetet buxhetore për këtë destinim nga ana e komunave përkatëse”.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

39. Gjykata vëren që parashtruesja pohon për shkelje të nenit 93 [Kompetencat e Qeverisë], paragrafëve 6 dhe 7, të Kushtetutës, nenit 23.2 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, dhe neneve 62 [Drejtorët Komunalë], paragrafi 3, dhe 24 [Parimet themelore të financave komunale], paragrafi 4, të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Nr. 03/L-040).
40. Megjithatë, për të gjykuar për kërkesën e parashtrueses, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesja i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë, të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës, në veçanti nëse parashtruesja i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit në fuqi, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47.2 të Ligjit.
41. Arsytimi për rregullin e shterimit është që t'u ofrojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjet efektiv për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shih, Aktvendim për Papranueshmëri: Maliqi dhe të tjerët kundër Shoqatës së Avokatëve të Kosovës, të 16

dhjetorit 2010, dhe *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, nr. 25803/94, Vendim i 28 korrikut 1999).

42. Sa i përket kërkesës në fjalë, Gjykata vëren që sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës, nëpunës civil është “*çdo person i punësuar i një organi të punësimit, rroga e të cilit paguhet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës*”, pra duke përfshirë edhe stafin mjekësor të sistemit shëndetësor.
43. Në këtë drejtim, parashtruesit, si nëpunës civilë, patën mundësi të inicionin procedurë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në pajtim me nenet 10 dhe 11 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës.
44. Megjithatë, Gjykata vëren që me miratimin e Ligjit Nr. 03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, stafi mjekësor i sistemit shëndetësor ishte lënë jashtë si kategori nga Shërbimi Civil në pajtim me nenin 4 [Kategoritë e punonjësve publikë të cilët nuk janë pjesë e Shërbimit Civil] të Ligjit Nr. 03/L-149.
45. Pavarësisht kësaj, Gjykata vëren që stafi mjekësor i sistemit shëndetësor, në pajtim me nenin 78 [Mbrojtja e të drejtave për të punësuarit] dhe nenin 79 [Mbrojtja e të punësuarit në Gjykatë] të Ligjit të punës Nr. 03/L-212, mund të ushtrojë padi në gjykata të rregullta.
46. Megjithatë, nga dokumentet e dorëzuara nga parashtruesja duket që ata nuk i kanë zbatuar procedurat e përcaktuara me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës apo me Ligjin e punës Nr. 03/L-212,
47. Prandaj, Gjykata konkludon që parashtruesja nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike që i ka në dispozicion sipas ligjit në fuqi.
48. Prandaj, rezulton që kërkesa duhet të hidhet poshtë në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47.2 të Ligjit.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit, dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 19 prill 2012, Gjykata Kushtetuese njëzëri:

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t’u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Dr. Iliriana Islami

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani

Shtojca A

Komunat

1. Komuna e Gjakovës
2. Komuna e Podujevës
3. Komuna e Kamenicës
4. Komuna e Lipjanit
5. Komuna e Pejës
6. Komuna e Mitrovicës
7. Komuna e Vushtrrisë
8. Komuna e Klinës
9. Komuna e Rahovecit
10. Komuna e Shtimes
11. Komuna e Kastriotit
12. Komuna e Prishtinës
13. Komuna e Fushë Kosovës
14. Komuna e Gjilanit